



**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Green Agro - AL” Sh.p.k.**

Sot, më date **12.10.2021**, ne te nenshkruarit:

- **Esterion Cjapi** lindur me 10/03/1992, shtetas shqiptar, me residence ne Samatice, Kutalli Berat, identifikuar me pasaporten me Nr. BB0120883, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
  - **Nazmi Hoxha** lindur me 22/01/1971, shtetas shqiptar, me residence ne Tirane, identifikuar me pasaporten me Nr. BI3929345, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- ; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“Green Agro - AL” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: **“Green Agro - AL” Sh.p.k**

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “Qender”, rruga kryesore, godine njekateshe me numer 6487, Samatice, Kutalli, Berat.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [greenagro.al@yahoo.it](mailto:greenagro.al@yahoo.it)  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

- Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Import dhe tregtim me shumice e pakice te impute bujqesore ,etj.
- Megjitheate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**





## Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **20 000 000** Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Esterion Cjapi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **10 000 000** leke që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Nazmi Hoxha**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **10 000 000** leke që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

## Neni 6:

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të behet vetëm pasi Asamblea e ortakëve me shumice e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese

## Neni 7:

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Neni 8

### Organi Vendimmarres







Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Aministratori i shoqërisë emërohet Z. **Esterion Cjapi** lindur me 10/03/1992, shtetas shqiptar, me residence në Samaticë, Kutalli Berat, identifikuar me pasaportën me Nr. BB0120883, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Aministratori i shoqërisë emërohet Z. **Afrim Sharku** lindur me 20/08/1966, shtetas shqiptar, me residence në Rahovec Kosovë, identifikuar me kartën e identitetit me Nr. 792841, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**


Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxirjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Neni 11**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**



Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statuin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**ESTERION CJAPI**



**NAZMI HOXHA**

